



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL Anr.755/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Linda Shahini kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.11.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Linda Shahini kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 15:50, ka pranuar një apel nga Linda Shahini kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, në të cilin pretendon se në fshatin Krojmir në vendvotimet: 1326e/01R, 1326e/02D si dhe në fshatin Rabafc në vendvotimin 1329e/02D, ka pasur parregullsi në procesin e numërimit të votave pasi që nuk është bërë saktë paraqitja e votave të saj dhe se votat e saj i janë bartur një kandidati tjetër.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## **Apeli është i pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se, apeluesi me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj, Paneli apelin e apeluesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i apeluesit u refuzoj si të pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.755/2017 me datën 11.11.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Rafet Haxhai**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.